
KONTRATË

SHITJE KUOTASH

Sot më datë 12.05.2022, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet kjo "kontratë për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

DISPOZITA PARAPRAKE:

- a.** Shoqëria "TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT" SHPK (K51612012D), nga këtu e në vijim referuar edhe si "TIA", është një shoqëri koncesionare e cila e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Marrëveshjen e Koncessionit të datës 15 tetor 2004, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004 – "Për miratimin e marrëveshjes së koncessionit për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza" - ndryshuar me ligjin nr. 55/2016 dhe ligjin nr. 16/2021;
- b.** **TIA ka** si objekt kryesor të aktivitetit koncesionar: "projektimin, financimin, ndërtimin, vënien në punë, mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë;
- c.** **Me** marrëveshjen për transferimin e kuotave, të datës 01.12.2020, shoqëria "Real Fortress Private Limited" në cilësinë e ish - ortakut të vetëm të shoqërisë koncesionare (TIA), transferoi plotësisht pronësinë mbi kuotat që zotéronte në shoqërinë koncesionare "Tirana International Airport" SHPK, tek shoqëria "Kastrati Group" SHA - **NUIS** K21711502V.
- d.** "Kastrati Group" SHA, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të TIA, menjëherë pas fitimit të pronësisë mbi kuotat e shoqërisë koncesionare, ndërmori kundrejt Qeverisë Shqiptare, **në** kuadër edhe të shtesës së marrëveshjes së koncessionit të ratifikuar me ligjin **nr.16/2021**, një sërë detyrimesh e angazhimesh të natyrës financiare. Qëllimi i këtyre angazhimeve është realizimi në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", i një investimi të konsiderueshëm prej më shumë se 100 milion Eurosh, me qëllim

modernizimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve tejet cilësore e bashkëkohore në këtë aeroport;

- e. Në përbushje të objektivave dhe detyrimeve të parashikuara në Shtesën e Marrëveshjes së Koncesionit të ratifikuar me Ligjin Nr. 16/2021, "Kastrati Group" SHA ka filluar prej disa kohësh implementimin dhe realizimin në aeroport, të punimeve të ndryshme modernizuese të cilat konsistonë kryesisht në rritjen e kapaciteteve të aeroportit, nëpërmjet zgjerimit të terminalit të pasagjerëve, zgjatimin e pistës, zmadhimin e hapësirës së vendparkimit të avionëve etj;
- f. Ndërkohe, është bërë gjithnjë e më evidente se realizimi i synimit për një aeroport modern e bashkëkohor, kërkon përveç kapaciteteve financiare, edhe njohuri të posaçme menaxhimi e drejtimi, të lidhura ngushtësisht me industrinë e aviacionit civil, e për këtë arsy, e bën të domosdoshme që administrimi i veprimtarisë së lidhur me koncesionin e TIA, të realizohet nëpërmjet një shoqërie me objekt të posaçëm aktiviteti, të lidhur ngushtësisht dhe vetëm me fushën e aviacionit civil;
- g. Për këtë qëllim, aksionari i vetëm i "Kastrati Group" SHA, ka krijuar shoqërinë "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK (M21612025K), me objekt të posaçëm aktiviteti ndër të tjera: *"Projektim, investim, ndërtim, administrim dhe menaxhim/operim i terminaleve dhe aeroporteve të aviacionit civil e jo vetëm, të strukturave, faciliteteve si dhe realizimi i te gjitha shërbimeve të lidhura me industrinë e aviacionit pa asnjë përvrashtim"*;
- h. Duke vlerësuar sa më sipër, Kastrati Group SHA nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash, dëshiron të transferojë 100% të kapitalit të shoqërisë "Tirana International Airport" SHPK tek shoqëria "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK, e cila nga ana e saj pranon këtë transferim, duke siguruar njëkohësisht edhe vijimin e të gjitha investimeve të marra përsipër nga TIA në kuadër të marrëveshjes së koncesionit të nënshkruar me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.
- i. Aksionari i vetëm i shoqërive "Kastrati Group" SHA dhe "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK përmes transferimit të kuotave dëshiron të riorganizojë dhe ristrukturojë shoqëritë e zotëruara prej tij me qëllim rritjen e performancës përmes specializimit të ngushtë dhe eventualisht rritjes së konkurrueshmërisë në tregun kombëtar dhe rajonal.

Për sa më sipër, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë për shitje kuotash si vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese

1) Shoqëria "KASTRATI GROUP" SHA, me NUIS K21711502V, nga këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**", përfaqësuar nga Administratori **Z. Gani Kastrati**.

dhe

2) Shoqëria "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK, me NUIS M21612025K, nga këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**", përfaqësuar nga Administratorja **Znj. Eda Spahiu**.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit kundrejt Blerësit të kuotës së zotëruar nga Shitësi, e cila përfaqëson **100% (njëqind përqind)** të kapitalit të shoqërisë "TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT" SHPK (NUIS K51612012D).

Neni 3

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi, është **EUR 45,000,000 (dyzetë e pesë milionë Euro)**.

Neni 4

Mënyra e pagesës dhe kalimi i pronësisë

4.1. Çmimi i shitjes i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, do të paguhet prej Blerësit në disa këste, përmes burimeve ekonomike të cilat do të realizohen nga Blerësi, të gjeneruara kryesisht si rezultat i veprimtarisë ekonomike të TIA. Palët me një marrëveshje të veçantë mund të detajojnë mënyrën e pagimit të çmimit të përcaktuar në këtë kontratë.

4.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, Blerësi shndërrohet në pronar me të drejta të plota të një kuote që përfaqëson **100%** të kapitalit të shoqërisë "TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT" SHPK, ose e shprehur në vlerë 1.161.148.885,37 Lekë. Për të evituar çdo dykuptimësi, palët kuptojnë se kjo kontratë krijon pasoja për to, menjëherë pas plotësimit të kushteve të cituara në nenin 7.4 më poshtë, pavarësisht pagesës ose jo të çmimit të përcaktuar më sipër. Transferimi i kuotës do të formalizohet përmes regjistrimit të kësaj

kontrate në regjistrin tregtar, regjistrim i cili mund të aplikohet nga secila nga palët dhe/ose TIA menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Neni 5

Të drejta e detyrime të palëve

- 5.1. Shitësi garanton se kuota objekt i kësaj kontrate është e transferueshme dhe se ai është i vetmi pronar e gjzon të drejta të plota mbi kuotën.
- 5.2. Shitësi pranon që çmimi i cituar në nenin 3 të kësaj kontrate, është çmimi i vetëm dhe përfundimtar në lidhje me shitjen e kuotës (kapitalit) që ai kishte në shoqërinë "Tirana International Airport" SHPK, dhe se për këtë qëllim nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim vijues të çdo lloj natyre. Në të njëjtën mënyrë shitësi pranon se mënyra e pagimit të çmimit është mënyra e vetme dhe përfundimtare dhe se ai nuk do të këtë asnjë pretendim vijues të çdo natyre në lidhje me këtë.
- 5.3. Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate, kuotë (kapital) që menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, i kalon Blerësit, ashtu sikurse edhe çdo e drejtë apo përfitim tjetër i lidhur me të, përfshirë edhe të drejtën e Blerësit për të përfituar çdo dividend të maturuar, të deklaruar apo aprovuar deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

- 6.1. Blerësi merr përsipër të paguajë çmimin e shitjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.
- 6.2. Blerësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga cilësia e tij e ortakut të TIA, përfshirë këtu të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kontrata e koncesionit dhe ligji i zbatueshëm i atribuojnë ortakut të shoqërisë koncesionare.

Neni 7

Të ndryshme

- 7.1. Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, palët bien dakord që kuotat e kaluara nga shitësi te blerësi janë të zhveshura nga çdo lloj dividendi i deklaruar, i maturuar apo për t'u paguar, deri në datën e hyrjes në fuqi.
- 7.2. Palët mund të detajojnë dhe rregullojnë çështje të tjera që lidhen me ketë transferim të kuotës me marrëveshje të veçantë. Në rast konflikti midis kësaj kontrate dhe marrëveshjeve të veçanta (nëse ka ose do të ketë të tillë) do të prevalojë parashikimi i

marrëveshjes së veçantë, e nëse ka konflikt midis marrëveshjeve të veçanta, do të prevalojë rregullimi më i vonë.

7.3. Pavlefshmëria e një a më shumë dispozitave të kësaj kontrate nuk e bën atë të pavlefshme në tërësi. Në një rast të tillë, kur evidentohet se një a më shumë dispozita të kësaj kontrate janë ose bëhen të pavlefshme, palët do të zëvendësojnë dispozitën/at e pavlefshme me të vlefshme të cilat i afrohen sa më shumë qëllimit të palëve të shprehur përmes dispozitave që janë ose bëhen të pavlefshme.

7.4. Vlefshmëria e kësaj kontrate, pra hyrja në fuqi, do të kushtëzohet nga plotësimi i kushteve si më poshtë vijon:

- a. Dhënia e pëlqimit me shkrim nga ana e Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA) në lidhje me nënshkrimin e kësaj kontrate;
- b. Dhënia e vendimit nga ana e Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet të cilit jepet autorizimi mbi transaksionin (përqendrimin), ose dhënia e një vendimi apo pëlqimi lejues për transaksionin në kushtet kur Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se nuk është e nevojshme të jepet një autorizim;
- c. Dhënia e pëlqimit/lejimit me shkrim në lidhje me transferimin e kuotave nga banka të nivelit të dytë me të cilat TIA ka një marrëveshje aktuale kredi-marrje. Në çdo rast ky pëlqim/lejim nuk mund të kundërshtohet në mënyrë të paarsyeshme apo të pa-justifikuar.

Neni 8

Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

8.1. Kjo kontratë përgatitet në 2 kopje, të dyja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

8.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve dhe plotësimin e të gjitha kushteve të cituara në nenin 7.4.

SHITËSI

“KASTRATI GROUP” SHA

Përfaqësuar nga administratori

Gani Kastrati



[Leptier, mbiemër, firmë vu e dhënë qërisë]

BLERËSI

“KASTRATI AVIATION HOLDING” SHPK

Përfaqësuar nga administratorja

Eda Spahiu



"KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK
NUIS M21612025K

Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë

Data: 12 / 05 / 2022

VENDIM I
ORTAKUT TË VETËM
"PËR BLERJEN E 100% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK"

Shoqëria "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK është regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 12.04.2022, me nr. NUIS M21612025K. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë. Ortak i vetëm i shoqërisë është **Z. Shefqet KASTRATI**.

Në cilësinë e Ortakut të Vetëm të shoqërisë dhe bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" – i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të jap miratimin për blerjen nga shoqëria "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK (NUIS M21612025K), të kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit që "KASTRATI GROUP" SHA zotëron në shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK me nr. NUIS K51612012D.
2. Autorizohet administratori i shoqërisë "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK të nënshkruajë në emër dhe për llogari të shoqërisë, kontratën përkatëse të shitjes së kuotës me "KASTRATI GROUP" SHA, duke pasur njëkohësisht të drejtën të negociojë të gjitha termat dhe kushtet e kontratës, pa asnjë përjashtim.

"KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK
ORTAKU I VETËM
SHEFQET KASTRATI



Datë 12/05/2022

**VENDIMI I ASAMBLESE SE SHOQERISE
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK**

Në Tiranë, sot më datë 12/05/2022 (Dymijë e njëzetë e dy) u zhvillua mbledhja e asamblesë së shoqërisë "TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT" SHPK (TIA), me praninë e Ortakut të Vetëm, shoqërisë "Kastrati Group" SHA me nr. NUIS K21711502V.

Ortaku i vetëm i shoqërisë përfaqësohet në këtë vendimmarrje nga Z. Shefqet Kastrati, i cili ka tagra të plota për të vendosur referuar pozitës së tij për çështjen e rendit të ditës.

Çështja e rendit të ditës është:

- Dhënia e miratimit për shitjen nga shoqëria "KASTRATI GROUP" SHA tek shoqëria "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK (NUIS M21612025K), të kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit që "Kastrati Group" SHA zotëron në shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK me nr. NUIS K51612012D.**

Pasi u diskutua çështja e rendit të ditës, Asambleja me prezencën e Ortakut të Vetëm,

VENDOSI:

- Të japë miratimin për shitjen nga shoqëria "KASTRATI GROUP" SHA tek shoqëria "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK (NUIS M21612025K), të kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit që "KASTRATI GROUP" SHA zotëron në shoqërinë TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK me nr. NUIS K51612012D.
- Autorizohet administratori i shoqërisë "KASTRATI GROUP" SHA të nënshkruajë në emër dhe për llogari të shoqërisë, kontratën përkatëse të shitjes së kuotës me "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK, duke pasur njëkohësisht të drejtën të negociojë të gjitha termat dhe kushtet e kontratës pa asnjë përjashtim.

ASAMBLEJA E SHOQERISE "TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT" SHPK

Ortaku i Vetëm (KASTRATI GROUP SHA)

Përfaqësuar nga:

Z. Shefqet Kastrati



[emër, mbiemër, firmë, vulë TIA]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ORGANI SHTETEROR I AUTORIZUAR

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISËNr. Prot. 1648 / DL. 7.9 / 2022

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj datë 12.05.2022

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISËNr. Prot. 6419 / Dt. 26.10.22

Z. GANI KAISTRATI
ADMINISTRATOR,
SHOQERIA "KAISTRATI GROUP" SHA

Për dijeni:

Znj. ERINDA XHAFERAJ
DREJTOR I PERGJITHSHEM
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Në përgjigje të shkresës tuaj, datë 12.05.2022, "Kërkeshë për miratimin e transferimit të kuotës që "Kastrati Group" SHA zoteron në shoqërinë "Tirana International Airport" SHPK, OSHA, në zbatim të pikës 35.2 (a) te Ligjit Nr 9312, datë 11.11.2004, i ndryshuar, si palë në Marrëveshje, shpreh dakordësinë për këtë transferim nga aksioneri aktual "Kastrati Group" sh.a te kompania "Kastrati Aviation" sh.p.k.

OSHA, duke konsideruar përcaktimet e Marrëveshjes së Koncessionit, si dhe duke vlerësuar faktin që blerësi i aksioneve "Kastrati Aviation" sh.p.k. në këtë Marrëveshje Koncesioni, është një sipërmarrje e dedikuar për aviacionin, sjell në vëmendje që në aspektin e realizimit të detyrimeve të kontratës, blerësi i aksioneve "Kastrati Aviation" sh.p.k., duhet të marrë përsipër të gjitha detyrimet dhe investimet kontraktuale të parashikuara në këtë marrëveshje dhe të garantojë zotërimin e kapaciteteve teknike, operacionale, infrastrukturore dhe financiare për vijueshmërinë e kontratës, sic përshkruhet në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Kastrati Group sha., përcjellë me shkresën e datës 07.06.2022, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Organji Shtetëror i Autorizuar, shpreh gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin në funksion të mbarëvajtjes së kësaj marrëveshje koncesioni.

MINISTRI

Delina Ibrahimaj



MINISTRI

Bejlinda Balluku





R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGjisë SË TREGJEVE

Nr. 356 prot.

Tiranë, më 01.06.2022

Lënda: Vlerësim mbi transaksionin e njoftuar.

Kastrati Aviation Holding

Sheshi Italia, Mak Albania Hotel

Tiranë

Autoritetit i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 356, prot AK, datë 24.05.2022 “Njoftim mbi kontratën e nënshkruar nga shoqëritë Kastrati Group SHA dhe Kastrati Aviation Holding SHPK për shitjen e kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë Tirana International Airport SHPK”, është njoftuar në lidhje me shit-blerjen e 100% të kuotave në shoqërinë Tirana International Airport SHPK.

Transaksi i depozituar nuk sjell ndryshim kontrolli në shoqërinë Tirana International Airport SHPK dhe nuk plotëson kriterin e parashikuar në nenin 10 të ligjit Nr.9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, për një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit.

Për këtë arsy, transaksi i nuk është objekt shqyrtimi nga Komisionit të Konkurrencës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



FATURE PER ARKETIM

Numër

34

Date

01.06.2022

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime, për llogari të institucionit tonë, me emërtim, kode, numër identifikimi dhe shuma si me poshtë:

Emri i Institucionit përfitues

Autoriteti i Konkurrencës1077001

Kodi i Institucionit përfitues

3535

Kodi i Degës se Thesarit ku vepron

Emri i paguesit (person /person fizik /person juridik)

Numri i Identifikimit te Paguesit

ID e Detyrimit	Përshkrimi i te ardhurave		Shuma qe Arketohet (Leke)
	Emërtimi	Kodi i Llog. Ekonomike	
	Njoftim i transaksionit të shitblerjes së aksioneve midis shoqërive Kastrati Aviaton Holding dhe Kastrati Group	<u>7113099</u>	<u>15,000</u>
X	TOTALI	X	<u>15,000</u> (pesëmbëdhjetë mijë)

Përfaqësuesi i Institucionit

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)



KLIENTI

(Person/ Person Fizik / Person juridik)

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Adresa:

Kontakti: